# AKTI I? THEMELIMIT (KONTRATE)

# I NDERMAJES TREGATRE PRIVATE "N O S H I "

Sot me daten /II/1995,une i quajturi Arjan Musa,i biri i Gencit,i datelindjes me 1964,lindur ne Kukes dhe banues ne Tirane, ne Rr."J.Derada",Nr.69,themeloj Ndermarjen Tregetare Private "NOSHI",me pergjegjesi te kufizuar,si ortak i vetem.

## NENI 1

Ndermarje Tregtare Private emerohet "NOSHI" SH.P.K. Import-Eks Port

## KOHE ZGJATJA

## NENI 2

Ndermarja Trehtare Private "NOSHI" SH.P.K. me ortak te vtem,krijohet me nje afat kohore mbi 15 vjet,me te drejte te riperseritje te ketij afati.

## SELIA E SHOQERISE

## NENI 3

Vendi i Ndermarjes Tregetare Private "NOSHI " SH.P.K. eshte ne Tirane dhe me seli ne RR."J.Derada",Nr.69.

## OBEJEKTI I VEPRIMATRISE

## NENI 4

Objekti i veprimtarise se saje so te jete""TREGTIM MALLRAVE TE NDRYSHEME,PJESE NDERRIMI AUTOMJETESH,MALLRA INDUSTRIALE,PAISJE ETJ. IMPORT-EKSPORT,MESHUMICE E PAKICE"

## NENI 5

Administrator i firmes "NOSHI" SH.P.K. do te jete Z.Arjan Musa.

## KAPITALI

Kapitali fillestare i Ndermarjes Tregtare Private "NOSHIRSH.P.K,do te jete 100.000 Leke;i cili eshte i depozituar ne llogarine rrjedhese ne Banken e Kukesit.

## NENI 6

Ndermarja Tregetare Private "NOSHI"SH.P.K. kriojhet e dote veproje sipas rregullave te vendosura ne Statutin e saje qe i bashkangjitet ketij Akti Themelimi.

FIRMA
" N O S H I "
ORTAKU I VETEM
/ Z.Arjan Musa /

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
- N O T E R I A -

Nr.________________Rep
Nr.________________Kol

V E R T E T I M

Sot me daten 6 /II/1995,u paraqit personalisht ne Noterin e Tiranes Z.Arjan Musa,madhore me zotesi te plote juridike per te vep uar,per idednitetin e te cilit u sigurova nga leternjoftimi i tije pe sona,i cili me deklaroi se :Sa me siper eshte i perpiluar nje akt-the limi,me deshiren time te lire dhe te plote dhe e nenshkruaj ate rregu llisht para noterit dhe une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

PULLE TAKSE 5 LEKE R.SHQIPERISE

PULLE TAKSE 5 LEKE R.SHQIPERISE

N O T E R I

LULEZIM FORTUZI
NOTER
TIRANE-ALBANIA
Tel 355 42 264 98
Rr "Barrikadave" Nr 102

# S T A T U T

## I SHOQERISE TREGETARE "NOSHI" SH.P.K

## ( IMPORT - EKSPORT )

## ORTAK I VETEM

## FORMIMI

### NENI I

Formohet shoqerija tregtare "NOSHI" SH.P.K.ne Kukes nga Arjan Mus ,i biri i Goncit ,i datelindjes me 1964,lindur ne Kukes dhe banues ne Tirane,Rr."J.Derada",Nr.69,si ortak i vetem,me seli te shoqerise ne qytetin e Kukesit,Lagjia Nr.2,Pall.2,Shk.2,Ap.5

## SELIA E SHOQERISE

### NENI 2

Selia e shpqerise tregtare "NOSHI" eshte ne Kukes,Lagjia 2 Pall.2,Shk.2,Ap.5.Kjo shpqeri ka te drejte te hape deges e tjera te saje ne forme filiali ne te gjithe qytete e Shqiperise,apo dhe jashte territorit te saje,duke respektuar legjislacionin Shqipetare.

### NENI 3

Shoqeria "NOSHI" SH.P.K. do te kete vulen e saje ne forme te rrombullaket ,me qender te saje do te jete e shenuar "NOSHI".

## KOHE ZGJATJA

### NENI 4

Ndermarja Tregtare "NOSHI" SH.P.K. do te kete nje kohe zgjatje mbi I5 vjet,me te drejte te riperteritjes se saja te ketij afati.Ajo mund te shperbehet ne cdo kohe.

## OBJEKTI I VEPRIMTARISE

### NENI 5

Ajo ka nje objetk te vepriitarise se saja "TREGETIM TE MALLRAVE TE NDRYSHEME,PJESE NDERRIMI TE AUTOMJETEVE,MALLRA INDUSTRIALE PAISJE ETJ. IMPORT-EKSPORT ME SHUMICE E PAKICE".

NENI 6

Shoqerija mund te ndryshoje emrin,seline,si dhe objektin e veprimtarise se saje,sipas vendimit qe do te marre ortaku i vetem.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 7

Kapitali i shoqerise eshte 800.000 Leke,i formuar ne masen e tije te plote nga ortaku i vetem.

NENI 8

Kapitali i, shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimeve qe do te marre ortaku i vetem.

NENI 9

Shoqerija Tregtare "NOSHI"SH.P.K. do te kete llogari rrejdhese ne qytetin e Kukesit.Ajo ka te drejte te hape llogari rrjedhese dhe ne Bankat e tjera qe veprojne ne Republiken e Shqiperise.Ajo detyrohet te mbaje dokumentacion te rregullt,te beje parashikimet dhe te nxjerre bilancet ne aftet e caktuara(mujore,tremujore,vjetore),te plotesoje te gjitha detyrimet ndaj shtetit dhe organeve shteterore.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

NENI IO

Ne baze te nenit 6 te ligjit Nr.7638,date I9/XI/I992,"Per shoqerote tregtare",dge te nenit 5 te ligjit 75I2,date IO.8.I99I"Per nismen e lire private"shoqerija tregtare "NOSHI"SH.P.K. e fiton personalitetin e saje Juridik me rregjistrimin e saje ne Gjykaten e Rrethit Tiranes, dhe ushtron veprimtarine e saje me rregjistrimin ne organet tatimore.

NENI II

Shoqerija "NOSHI"SH.P.K. perfaqesohet nga ortaku i vetem dhe Administratori i vetem i saje Z.Arjan Musa.Ose nga persona te autorizuar prej tije ose te paisur me prokure te pergjitheshme ose te posacme.Ata kane te drejte te kryejne veprime Juridike ,trehtare brenda kompetencave dhe tagrave te percaktuara ne prokure apo statut.

NENI I2

Shoqerija "NOSHI"SH.P.K. eshte prone e themeluesit te saja Z. Arjan Musa.

NENI I3

Ajo merr vendime ne zbatim te ligjeve ne fuqi dhe sipas ketije statuti,te cilat jane te detyrushme per te gjithe punonjesit e kesaj shoqerije.

NENI I4

Ortaku i vetem sipas nevojave te paraqitura per zhvillimin e veprimtarise se shoqerise,emeron administratorin e vetem Z.Arajn Musa dhe puneson punonjes te veprimtarive te dnrysheme qe ka noje Shoqeria

NENI I5

MARDHENIET E PUNES

Mardheniet e punes si pranimet dhe largimet nga puna,masat displinore,pagat,shperblimet,cdemtimet dhe probleme te tjera te kesaj natyre do te rregullohen nga kontratat idividuale te punes,qe do te lidhen me te punesuarit,ne baze te legjislavcionit te punes ne Republiken e Shqiperise.

NENI I6

Ortaku i vetem i shoqerise dhe administratori,jane te veshu me te gjitha kompetenvat per drejtimin e zakonshem e te jashtezakonsh te shoqerise pa asnje lloj kufizikmi.Ata kane te drejte te kryejne te gjitha veprimet qe i konsiderojne te nevojeshme per arritjen e qellim ve te shoqerise.Ata kane te drejte midsi te tjerash te kembejne pasur te lidhen me shoqeri te tjera te vendit ose te huaja,te kryejne cdo llojveprimi prane te gjitha zyrave private apo shteterore,qe kane te bejen me garacite,ipotekat.Te kryejen prane instituteve bankare e fin nciare veprime depozitimi,kredittimi,pagesa dhe arketime.Ne keto rast personi i autorizuar ka per detyre te njoftoje e te jape llogari per te gjitha ortakut te vete.

NENI I7

Perfaqesimi i shoqerise "NOSHI"SH.P.K.i perket ortakut te vetem dhe administratorit.Ata kane te drejten e perfaqesimit te shoqerise ne organet Gjyqesore dhe administrative.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

NENI I8

Veprimet ekonomike financiare te shoqerise mbyllne me /3
Dhjetor te vitit.

Ne fudnte cdo periudhe ,administratori nxjerr bilancin kontabel te shoqerise ne llogarine FITIM,HUMBJE,mbeshtetur ne ligje dhe rregulla te mbajtjes se kontabilitetit nga subjektet private percaktuar nga organet kompetente te sistemit fiskal.

Bilanci kontabel miratohet nga ortaku i vetem,i cili vednso per k ijimin e fondeve te dnrysheme te nevojeshme per zhvillimin e garantim e shoqerise,fondin e akumulimit,fondin rrezerve etj.

NENI I9

Te ardhurat neto pas vecimit te fondeve ligjore te permen ra me siper dhe shlyerjen e detyrimeve fiskale nga fitimi mbesin per perdorim ortakut te vetem.

SHPERNDARJA E SHOQERISE

NENI 20

Shperndarja e shoqerise mund te vije ne cdo kohe dhe per cfardo lloj shkaku,si humbja e kapitalit,pamundesija e veprimatrise e Ne keto raste ortaku i vetem vendso mbi menyren e likujdimit dhe cakt nje ose disa likujditor.Keta bejen kujdes qe shoqerija te likujdoje m pare detyrimet qe ajo ka personave fizik e juridik(persomave te tret)

Neni 2I

Shoqerija "NOSHI" vepron ne rregjimin e prones dhe merr persiper vete te drejta dhe detyrime.Ajo pergjigjet vete per detyrimet ndaja kontraktore e jashte kontraktore,brenda kapitalit te saje.Ortaku i vetem mbart rrezikun e veprimtarise se shoqerise ne nivelin e shumes se mjeteve te investuara ne shoqeri.

DISPOZITA TE PERGJITHESHME

NENI 22

Persa nuk eshte shprehur ne kete statut i referohet plotesisht lig eve qe veprojne ne Republiken e Shqiperise.

NENI 23

Ky statut u perpilua ne kater kopje,per tju dhene sejcilit organ nga nje kopje.

FIRMA
" N O S H I "
ORTAKU I VETEM
/ Z. Arjan Musa /

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
-N O T E R I A-

Nr. 368 Rep.
Nr. 181 Kol.

V E R T E T I M

Sot me daten 6 /II/I995(nentedhjetpese),ne zyren e noterise ne Tirane,u paraqit personaslisht Arjan Musa,madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar,per didenditetin e te cilit u sigurova nga leternjoftimi i tije personal,madhore,i cili me deklaroi se :Sa me siper eshte e perpiluar nje statut,me deshiren time te lire dhe te plot dhe e nenshkruaje ate rregullisht para noterit,dhe une noteri e verteto ate sipas ligjit.

N O T E R I

LULEZIM FORTUZI
NOTER
TIRANE-ALBANIA
Tel 355 42 264 98
R. "Barrikadave" Nr 102

PULLE TAKSE 5 LEKE R.e SHQIPERISE
PULLE TAKSE 5 LEKE R.e SHQIPERISE